



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 39 Prot

Tiranë, më 13.05.2013

VENDIM Nr. 22 dt. 10.05.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.05.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me Projekt rikonstruksioni dhe ngritje kati i godinës së Bashkisë Kavajë.

VENDOSI

T'i propozojë Ministrit të MTKRS heqjen e statusit monument kulture të kategorisë së II për ndërtesën e Bashkisë Kavajë, pasi objekti i sipërpërmendur nuk përmban asnjë vlerë kulturore - arkitektoniko apo historike për të gëzuar statusin monument kulture.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI

SEKRETAR I KKR

AKADEMIK. APOLLON BAÇE